

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “HIDEOLAB” sh.p.k

#### **Neni 1: Data e Themelimit, Emri, Themeluesit dhe forma ligjore**

Sot me **date 05/11/2019**, une i nenshkruari:

**LINDITA MANE**, lindur me 25/12/1965 ne Elbasan, mbajtes i dokumentit tip karte identiteti e me nr personal: G56225052V, themeloj *shoqerine me pergjegjesi te kufizuar* me emrin:

#### “HIDEOLAB” sh.p.k

#### **Neni 2: Selia**

Selia e shoqerise do te jetë: **Lagja 3, Sheshi Liria, EGT Center Kt.4, Nr.24, Durres,**

#### **Neni 3: Objekti i aktivitetit**

Shoqeria do kete per objekt te aktivitetit te saj:

- Disenjim Software
- Zhvillim dhe mirmbjtje sistemes software
- Testim software
- Disenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit
- Disenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise
- Disenjim dhe zhvillim sistemesh te migrimit
- Permiresim sistemesh informatike
- Operim, menaxhim, suportim i perdonimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software
- Cdo aktivitet tjeter te lejuar nga ligji ne funksion te objektit te shoqerise.

#### **Neni 4: Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqeria do zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

## **KREU II**

## **Kapitali i regjistruar**

### **Neni 5: Vlera e kapitalit të regjistruar**

Kapitali i shoqerise eshte 60.000 leke, i ndare ne 1 kuote. Kontributi ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte vleresuar si me poshte:

**LINDITA MANE**, zoterues i 1(nje) kuote me vlerë 60.000 leke qe perkon me 100% te kapitalit; Kontributi I ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te fuajteshme/te paluajteshme apo te drejta)

### **Neni 6: Trasferimi I kuotave**

Kuotat e shoqerise apo te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te trasferohen nepermjet:

- a) Shitblerjes
- b) Trashigminise
- c) Dhurimit
- d) Cdo memyre tjeter te parashikuar me ligj

### **Neni 7: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Asambleja e per gjitheshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmahoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates.

Zmadhimi I kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga asambleja e per gjitheshme me shumice te kualifikuar te votave.

Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjitheshme. Ky vendim merret me shumice te kulaifikuar te votave.

## **KREU III**

### **Organet vendimarrese dhe drejtuese**

### **Asambleja e Përgjithëshme e ortakeve**

### **Neni 8: Të drejtat dhe detyrimet**

Asambleja e Përgjitheshme e ortakeve, eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise. Konkretisht, Asambleja merr vendime per sa me poshte:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve te administratorëve, likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ~~përdaj~~ administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

#### **Neni 9: Thirrja e Asamblesë së Përgjithëshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët te pakten dy here ne vit, per te miratuar perkatesisht bilancin vjetor te mbylluar si dhe bilancin vjetor parashikues.

Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Ne kete rast, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të dispõnojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Ne kete rast, Asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Ne kete rast, Asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

#### **Neni 10: Menyra e thirrjes**

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit te pare të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 11: Thirrja e asamblesë nga ortaket e pakicës

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me nenin 10 ne kete statut.

Nëse, në kundërshtim me percaktimin e ketij nenit, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej aksionereve te pakices nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

### Neni 12: Përfaqësimi ne Asamblenë e Përgjithshme

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### Neni 13: Kuorumet dhe marrja e vendimeve

Në rastin e marrjes së vendimeve te zakoneshme, që kërkojnë një *shumicë të thjeshtë pakualifikuar*, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë *shumicë të kualifikuar*, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me *shumice te kualifikuar* prej *tri te katërtat* e votave të ortakëve pjesëmarrës, për:

- a) ndryshimin e statutit,
- b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
- c) shpërndarjen e fitimeve,
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Për çështjet e tjera të renditura në nenin 8 te këtij statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Mbledhja e Asamblese drejtohet nga administrator nese eshte thirrur prej tij. Nese Asambleja e Pergjitheshme eshte thirrur nga pakica, atehere ajo kryesohet nga një nga ortaket e zgjedhur nga pjesemarresit ne ate mbledhje.

Administratori edhe ne rastin kur nuk eshte ortake I shoqerise, ka te drejten e pjesemarrjes si dhe te marri fjalen ne edo mbledhje te Asamblese se Pergjitheshme.

#### **Neni 14: Votat e pjesëmarrësve**

Cdo kuote i jep ortakut te pranishem apo perfaqsuesit te tij te autorizuar te drejten e një vote.

Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e asamblese se pergjitheshme nese nuk ka shlyer te gjitha detyrimet ne lidhje me kuotat qe ai disponon.

#### **Neni 15: Emërimi I Administratorit**

Administrimi si dhe perfaqsimi I shoqerise I besohen një apo me shume adminiistratoreve që mund edhe te mos jene ortake te shoqerise.

Afati maksimal i emerimit te administratoreve eshte 3 vjet me te drejte riperteritje.

Administrator i pare i shoqerise emerohet z. **LINDITA MANE**, me një mandat 3 vjecar, te cilit i jepen te drejta e percaktuara ne kete statut. Administratorit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqsimit te shoqerise.

Asambleja e Pergjitheshme mund te shkarkoje ne cdo kohe Administratorin nga detyra, me shumice te zakoneshme.

#### **Neni 16: Kompetencat e Administartorit**

Administratori i shoqerise ka te drejte dhe detyrohet:

Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- a) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- b) kujdesen pér mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme pér miratim;
- d) të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë;
- f) të raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjitheshme, ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

### Neni 17: Përgjegjësitë e Administartorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidale sipas rastit.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arrijen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- f) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratorët veprojnë nëkundërshtim me detyrat dhe shkelin standarde profesionale, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkura. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- d) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) japidin kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit

### **Neni 18: Mbledhjet e administratorit**

Administratori kujdeset qe ne libra te posacem te mbaje process verbalet e te gjitha takimeve te kryera nga ai, si dhe te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjitheshme.

## **KREU IV**

### **Neni 19: Viti Finaciar**

Viti finaciar fillon me date 1 Janar dhe mbyllet me date 31 Dhjetor. Viti i pare finaciar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne organet perkatese sipas legjislacionit ne fuqi.

### **Neni 20 : Shpërndarja e fitimit vjetor te shoqërisë**

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë në raport me kuotat e zotëruara.

Asambleja e per gjitheshme mund te vendose qe fitimi I vitit finaciar ose e një pjese te tij, te mos I shperndahet ortakeve por te perdoret per zmadhimin e kapitalit apo per qellime te tjera te gjykuara te dobishme per shoqerine dhe te lejuara nga ligji.

## **KREU V**

### **Prishja – Riorganizimi i shoqerisë**

#### **Neni 21: Prishja dhe likuidimi**

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e per gjitheshme emeron një likuidator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjitheshme, te marre me shumicë te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likuidatori shperndan pjesen e mbetur te shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqsojne.

#### **Neni 22: Ftesa për kreditoret**

Likuiduesi duhet te njoftoje kreditoret per te depozituar pretendimet ndaj shoqerise. Shoqeria e publikon kete njoftim sipas percaktiveve te dispozitiveve ligjore. Pretendimet duhet te depozitoohen Brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

#### **Neni 23: Përfundimi I likuidimit**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetur, likuiduesi njofton organet perkatese dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

#### **Neni 24: Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit Shqiptar.

Per cdo ceshtje e cila nuk gjen percaktim ne nenet e ketij statuti do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo ligji specific ne Republikene Shqiperise

#### **Neni 25: Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin me zbatimin apo interpretimin e normave te ketij statuti, si dhe per mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetetnte Gjykata Shqipetare.

#### **ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSITË KUFIZUAR**

Emri mbiemri dhe nenshkrimi

**LINDITA MANE**

